



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELLO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
N/Br. 33/20
Datë/Datum. 12.02.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	12.02.2020
REFERENC-Ë:	33 / 20
PËR/ZA/TO:	AK –Komuna e Prishtinës OE – “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj
NGA/OD/FROM:	Goran Milenković Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	N J O F T I M

Operatori Ekonomik: “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj, si palë e pa kënaqur më datën: 16.01.2020, ka parashtruar ankesë me nr. 33 /20, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “ALFA I ” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284 -5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës , duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 16.01.2020, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj.

Eksperti teknik i prokurimit më datën: 03.02.2020, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç’rast ka vlerësuar se ankesa e Operatori Ekonomik: “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj, është pjesërisht e bazuar dhe ka rekomanduar panelin shqyrtues që të anulohet B58 -Njoftimin për dhënie të kontratës , dhe rekomandon që lënda të kthehet në RI – VLERSIM.

Me datën: 03.02.2020, Autoriteti Kontraktues: Komuna e Prishtinës, si dhe parashtuesi i ankesës: “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj, e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284 -5-1-1.

Autoriteti kontraktues AK- Komuna e Prishtinës përmes parashtresës së datës: 04.02.2020, pas pranimit të raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 03.02.2020, që ky aktivitet i prokurimit të rivlerësohet.

Operatori ekonomik “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj, përmes parashtresës së datës: 04.02.2020, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së, në raportin e datës: 03.02.2020.

Paneli Shqyrtues, njofton operatorin ekonomik ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit: 616-19-6284 -5-1-1, të **RI-VLERESOHET** ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues “Rahovica Commerce”shpk-Ferizaj konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues:

z. Goran Milenković _____ Kryetari i Panelit Shqyrtues.

z. Nuhi Paçarizi _____ Referues.

z. Blerim Dina _____ Anëtar.